



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 050

Prishtinë, më 11, 12 e 15 dhjetor 2008

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 11, 12 DHE 15 DHJETOR 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 78 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u lajmërua deputeti **Gani Geci**, i cili tha se para gjashtë muajve ka parashtruar pyetje parlamentar lidhur me Shërbimin korrektues të Kosovës, por nuk ka marrë përgjigje. Ndërkohë, ka ndodhur që të bongurit të ikin nga burgu i Dubravës, kurse burgu nuk menaxhohet mirë.

Deputeti **Sadik Idriz** kërkoi nga Qeveria e Kosovës që të ndalojë zbatimin e Projektit të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, me arsyetim se është e implikuar një grup i interesit rreth SLS-së për t'i shfrytëzuar mjetet e kësaj ministrie në mënyrë jokorrekte.

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008
2. Koha për pyetje parlamentare,
Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen,
8. Rishqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët,
9. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad Hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Mediave, dhe
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad Hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008

Kuvendi i miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Njomza Emini** parashtoi pyetje për ministrin e Kulturës, Valton Beqiri, lidhur me programin e Qeverisë 2008-2011 për finalizimin e Planit kosovar të veprimit për rini.

Ministri Valton Beqiri iu përgjigj deputetes Emini.

Deputetja **Luljeta Shehu** parashtoi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me fatin e të pagjeturve.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** iu përgjigj pyetjes së deputes Shehu.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi lidhur me reformat në sistemin e drejtësisë

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për ministrin Bujqësisë, Idriz Vehapi, lidhur me produktet bletore.

Ministri Idriz Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për ministrin Bujqësisë, Idriz Vehapi, lidhur me bletët vendore.

Ministri Idriz Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka

Deputeti **Enis Kervan** parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me nxënësit me nevoja të veçanta.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Kervan

Deputetja **Nurishahe Hulaj** parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me nostrifikimin e diplomave universitare

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj

Kryetari propozoi që pika e katërt të shqyrtohet si pikë e tretë, për shkak të agjendës së Kryeministrit. Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, Ahmet Shala, tha se do t'i paraqes katër projektligje, të cilët, në fakt, janë ndryshim i rregulloreve jo në substancë, por vetëm në formë dhe në norma. Projektligji për ndryshimin e vlerës së shtuar, përkatësisht të TVSH-së, është komplet Rregullorja në fuqi, ndryshimet janë vetëm sipërfaqësore. Është ndryshimi i titullit, në vend të rregullores është ligj dhe në vend të normës 15% rritet për 1%, përkatësisht bëhet 16%. Për hir të kompensimit të uljes së normës për korporatat dhe të uljes së normës për pagat individuale ose të hyrat individuale, ne e kemi ngritur TVSH-në për 1% dhe ndryshimet tjera të vogla janë: termi “Rregullore” zëvendësohet me termin “Ligj”, termi “Autoritet Bankar dhe i Pagesave” zëvendësohet me “Bankë Qendrore” dhe termi “PSSP” zëvendësohet me “Kuvendi i Republikës së Kosovës”.

Me qëllim që politikat e Qeverisë së Kosovës për zvogëlimin e normave, përkatësisht rritjen ose ndryshimin e politikave fiskale, të jenë të mundshme të fillojnë me 1 janar, ne jemi marrë vesh edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa që të fokusohemi vetëm në ndryshimet të cilat e ndërrojnë normën dhe i ndërrojnë këto thirrjet elementare, andaj ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj, i cili është tepër i rëndësishëm për të zhvilluar politikat e Qeverisë së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzeje Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Mufera Sinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović, si dhe deputetët: Driton Tali, Ardian Gjini, Riza Smaka, Fatmir Rexhepi, Armend Zemaj, Adem Hajdaraj, Ibrahim Gashi, Berim Ramosaj, Gani Buçinca,

Bajram Kosumi, Naser Osmani, Sllavisha Petković dhe Vezira Emrush, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i seancës e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 30,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj nga fusha e përgjegjësisë të tyre dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së

Kryetari ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupi Parlamentar të AAK-së që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupi Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, tha se arsye pse e kemi thirrur interpelancën lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, është se procesi i integritet evropian është i rëndësishëm jetike për Kosovën, përderisa nuk kemi parë seriozitet, i cili mund t'i rrijë karshi seriozitetit të procesit nga ana e Qeverisë deri më tani. Dhe, vetë fakti që deri më tani nuk kemi asnjë përgjigje në më se 100 pika, të cilat përmenden në raport, tregon se as vetë raportin Qeveria nuk e ka marrë seriozisht.

Çështja tjetër, është joserioziteti gjatë negociimit të raportit. Qeveria ka shkuar në Bruksel dhe e ka negociuar gjuhën, ku ka qenë e shkruar – nuk ka progres fare, është kërkuar që të thuhet ka pak progres.

Çështja e fundit, është se keni humbur shansin për t'i treguar botës se Kosova mundet vetë.

Te brendia e materialit, i kam grupuar disa çështje për të mos shkuar te secila, se janë më se 100. E para, si grupim është paaftësia qeverisëse, do të thotë moskoordinimi qeveritar. Për shembull, thotë “strategjia legjislative nuk ka data, nuk është e harmonizuar me asgjë” dhe ka ardhur pas një viti punë. Pastaj, “rishikimi i buxhetit ka qenë shkelje e Kushtetutës”, thotë Komisioni Evropian. Tjetra, thotë, është shkatërrimi i shërbimit civil. Tetë sekretarë permanentë për tre muaj janë shkarkuar prej pune, pa dhënë arsyen.

E përmend mosemërimin e njerëzve nëpër organe vitale, për shembull, bordet mbikëqyrëse janë thatë. Nuk ka borde mbikëqyrëse. Thotë FSK-ja, AIK-ja, i përmend të gjitha me radhë, thotë nuk janë emëruar dhe tregon se është dhënë afat.

Për ekonominë thuhet se ka degradim në Kosovë, jo përparim, krahasuar me vitin e kaluar. Komisioni thotë se ka prej 0,5 deri 5 milionë keqpërdorim në secilën ministri për më pak se një vit të kaluar.

Thuhet në Raport se Grupi ndërmintor për Antikorrupsion nuk është themeluar dhe se në këto borde mbikëqyrëse për antikorrupsion ka përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe të Zyrës së Presidentit dhe se ne nuk e dinë si e garanton paanësinë politike ky veprim.

Komisioni, po ashtu, e ka përcjellë tenderin e "Rilindjes". I ka përcjellë sekretarët permanentë dhe urdhëresat për moszbatim të ligjit. E keni urdhëresën për moszbatim të Ligjit për duhanin.

Te sundimi i ligjit, kemi dëgjuar shpesh, thuhet: gjyqet. Nuk janë gjyqet. Gjyqet janë efikasiteti i Gjyqësorit. Sundimi i ligjit është, për shembull, sekretarët permanentë. Sundimi i ligjit është "Rilindja". Kuvendi ka thënë jo, Qeveria e bën. Sundimi i ligjit janë doganat. Domethënë, moszbatimi i Ligjit për duhanin, për shembull, iu jepet urdhër doganave mos ta zbatojnë ligjin. Nuk e dimë pse. Thirret shefi i Agjencisë Antikorrupsion te zëvendëskryeministri.

Në fund, po i jap disa reflektime. Për shembull, po kthehem pak te doganat. Ju e dini që është shkarkuar drejtori i përgjithshëm i doganave njëherë. Nuk e dimë si është kthyer, por në raport të Komisionit doganat lavdërohen, thuhet se është punë shumë e mirë. Tani ne nuk e dimë se kush e ka gabim?

I krahasoni faqet 8 dhe 9 të raportit të vitit të kaluar me faqet 10 dhe 11 të raportit të këtij viti për qeverisjen dhe për korrupsionin. Ekzistojnë disa shkallë të klasifikimit të problemeve. Një shkallë thuhet se korrupsioni është evident, një shkallë tjetër thotë se korrupsioni është serioz, një shkallë tjetër thotë se korrupsioni është brengosës dhe një shkallë tjetër thotë se korrupsioni është shumë brengosës. Në raportin e këtij viti thotë se korrupsioni është shumë brengosës, do të thotë është shkalla më e lartë e klasifikimit të brengës të cilën e shpreh Unioni Evropian.

Dhe, në fund, thuhet në raport "mediat intimidohen", që do të thotë në përkthim realisht frikësohen ta kryejnë punën e vet, dikush mund ta përkthejë – edhe kërcënohen.

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës të marrë fjalën.

Kryeministri **Hashim Thaçi** prezantoi qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Raportin Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, që përfshinë vitin 2007-2008.

Raporti i progresit të Komisionit Evropian është një formë e rregullt e komunikimit të Republikës së Kosovës me Komisionin Evropian për progresin e arritur brenda periudhës njëvjeçare.

Raporti i progresit përfshinë periudhën 1 tetor 2007 – tetor 2008. Raporti i ri vlerëson progresin e arritur në Kosovë në drejtim të përmbushjes së kriterëve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në të njëjtën kohë paraqet sfidat për të ardhmen e vendit tonë.

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është mjaft kompleks dhe sfidues. Kosova tashmë është pjesë e rëndësishme e këtij procesi, i cili, padyshim do të rezultojë me anëtarësimin e plotë të Kosovës në strukturat Euro-atlantike.

Ky është një përkushtim normal dhe ne jemi të vetëdijshëm se Republika e Kosovës do të ketë sfida tjera që të hyjë në rrugën e sigurt të integriteteve evropiane. Për këtë arsye, kemi marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar sa më shumë rrugën tonë.

Raportet që janë bërë deri më sot për Kosovën nga Komisioni Evropian kanë qenë reale apo kritike për sektorë të caktuar dhe kjo është krejt normale për gjendjen të cilën e kemi kaluar si vend dhe popull, sepse reformat nuk ndodhin brenda natës, e Kosova është shtet i pavarur tash e nëntë muaj.

Raporti i progresit vlerëson vendimet e institucioneve të Kosovës, vendimet e Qeverisë edhe për privatizimin, për privatizimin e Postë Telekomit, KEK-ut, aspektet e distribuimit, procesin

e koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, fillimin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e re” dhe vendimin për fillimin e ndërtimit të hidrocentralit në Zhur me 300 megavatë. Mirëpo, ka pasur edhe vërejtje aty-këtu sa i përket privatizimit, por dua të sqaroj edhe një herë para jush, para të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe para miqve ndërkombëtarë se kjo është filozofia politike dhe qeverisëse e jona që, në fakt, përputhet me prioritetet e së djathtës, por unë respektoj edhe mendimet e të tjerëve.

Raporti i progresit të këtij viti është shumë më i avancuar sesa ai i vitit të kaluar. Kërkohej nga të gjithë forcim i luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vendimtar në këtë proces është vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i të gjitha institucioneve që t’i marrë këto rekomandime dhe t’i inkorporojë në agjendën e saj duke paraparë aktivitete konkrete për adresimin e tyre.

Ne do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen për ta realizuar menjëherë pas publikimit të raportit, me ç’rast Qeveria e ka marrë dhe analizuar raportin në mënyrë të detajuar dhe ka dalë me veprime konkrete ndaj Komisionit për adresimin e atyre sfidave në mbledhjen plenare të 15-të të takimit të mekanizmit përcjellës të stabilizim - asociimit.

Qeveria parasheh rreth 1.500 veprime konkrete si adresim ndaj partneritetit evropian dhe se këto do t’i përmbushim me vullnet, me përpikëri të plotë dhe me vizion të qartë.

Kjo tregon se integrimet evropiane mbesin prioritet kryesor për Qeverinë e Kosovës. Për ta bërë këtë, jemi kujdesur që t’i sinkronizojmë në mënyrë më të mirë dokumentet më të rëndësishme të Qeverisë, si Planin e veprimit të partneritetit evropian, Kornizën afatmesme të shpenzimeve, Planin vjetor të punës, Planin për investime publike dhe Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Vetëm në këtë mënyrë do të mund të kemi një politikë unike dhe të qëndrueshme për integrim sa më të shpejtë të shtetit të Kosovës në strukturat e Bashkimit Evropian.

Vlerësimet e Raportit të progresit janë plotësisht në pajtim me pozicionin dhe qëllimet për zhvillimet politike dhe institucionale të Qeverisë në fushat, siç janë: sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, rritja e dialogut dhe pajtimi ndërmjet komuniteteve.

Në vazhdim, Kryeministri **Thaçi** paraqiti Planin e veprimit të partneritetit evropian të Qeverisë së Kosovës, si dhe të arriturat e Qeverisë në këtë fushë, të cilat janë dhënë në formë të plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin lidhur me Interpelancën e Kryeministrit Hashim Thaçi.

Ai i njoftoi deputetët për kohën e ndarë për debat, si vijon: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka 37 minuta; Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike 25 minuta; Grupi Parlamentar i AKR-së 11 minuta, Grupi Parlamentar i AAK-së 11 minuta; Grupi Parlamentar i LDD-së 11 minuta; Grupi Parlamentar SLS-së 8 minuta; Grupi Parlamentar “7+” 7 minuta, si dhe deputetët e pavarur të gjithë së bashku i kanë 10 minuta.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Interpelancën e Kryeministrit Hashim Thaçi dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Mufera Sinik**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Slobodan Petroviq**, si dhe deputetët: **Donika Kada**, **Sabri Hamiti**, **Alush Gashi**, **Arsim Bajrami**, **Hajredin Kuçi**, **Njomza Emmini**, **Naser**

Rugova, Enver Hoxhaj, Xhezair Murati, Ahmet Isufi, Numan Baliq, Slavisha Petković, Esat Brajshori, Fatmir Limaj, Bojan Stojanović, Driton Tali, Vezira Emrush, Armdend Zemaj, Etem Arifi dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtij debati, Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve të dhëna gjatë kësaj interpelance, si dhe i falënderoi ata për kontributin e dhënë.

Në fund, **Ardian Gjini**, duke e përmbyllur Interpelancën tha se nuk kërkoj dorëheqjen e Kryeministrit sot, por kërkoj të analizohet Raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovë dhe të shihet se çka është duke ndodhur me Kosovën.

Në fund të kësaj interpelance, me propozimin e Kryetarit, Kuvendi nxori këto

P Ë R F U N D I M E

1. Ngarkohet Komisioni për Integritet Evropian që ta analizojë Raportin e progresit dhe të përgatisë një propozim të Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008, i cili do të shqyrtohet dhe miratohet në seancë plenare të Kuvendit.
2. Komisionet e tjera parlamentare, të përfshijnë në rendin e ditës të takimeve të tyre të rregullta, sfidat e integriteteve evropiane, si pikë të veçantë, në mënyrë që të sigurojnë që Plani i veprimit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008 të realizohet plotësisht. Komisionet parlamentare t'ia dërgojnë informacionet e tyre rregullisht Komisionit për Integritet Evropian.
3. Komisioni për Integritet Evropian çdo tre muaj do t'i raportojë seancës plenare të Kuvendit për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit për vitin 2008.
4. Obligohet Qeveria e Kosovës dhe ministrinë e saj që t'i ofrojnë bashkëpunim dhe informacion të rregullt Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve gjegjëse parlamentare në realizimin e pikave të sipërpërmendura.

Kryetari dha pauzë për drekë deri në orën 16,30.

Pas pauzës, në mungesë të kuorumit, seanca u shty për të nesërmen.

Vazhdimi i seancës, më 12. 12. 2008

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Projektligji në të ardhurat e korporatave, në përmbajtje është Rregullorja që ka qenë në fuqi. Mirëpo, në substancë, nëse mund të them, është një ndryshim fundamental, sepse ndryshimi i taksave është 50% më i ulët. Pra, ne përgjysmojmë taksat, nga 20% sillen në 10%.

Ky ligj ka shndërruar në aspektin teknik Rregulloren 2004/51 në ligj. Ne do të përgatitim komplet ligjin gjatë pranverës, për hir të sjelljes më të shpejtë të vendimeve të Qeverisë, të sjelljes së Kosovës në hartën e vendeve me taksa më të ulëta.

Me taksën mbi profitin do të sjellim në kuadër të regjionit, por taksat mbi të hyrat individuale do të sillen më të ulëtat në regjion dhe mesatarja do të jetë diku mbi 5.2 përafërsisht.

Ndryshimet e normës tatimore janë bërë në nenet 5, në nenin 27, në nenin 29 dhe në nenin 31 të kësaj Rregulloreje, përkatësisht të Rregullores 2004/51. Disa ndryshime terminologjike të cilat janë bërë, faktikisht termi “Rregullore” është zëvendësuar me termen “ligj”, termi “Autoritet Bankar i Pagesave të Kosovës” është zëvendësuar me termin “Banka Qendrore” dhe, natyrisht, termi “PSSP” është zëvendësuar me termin “Kuvendi i Kosovës”.

Ky është një nga vendimet e fuqishme të Qeverisë së Kosovës për të mundësuar dy gjëra, që korporatat, përkatësisht kompanitë e Kosovës të jenë në vend të barabartë me regjionin. Përmes kësaj do të luftohet informaliteti.

Qeveria e Kosovës, pas shumë analizave, ka ardhur me këtë propozim dhe i lus deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Etem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sllobodan Petroviq, si dhe deputetët: Myrvete Pantina, Driton Tali dhe Riza Smaka, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i seancës e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër-----3,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj nga fusha e përgjegjësi të tyre dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Projektligji për tatimin në të ardhura individuale është në kuadër të pjesës së paketës fillestare të reformës fiskale. Dy faza janë që ne do të jemi të fokusuar gjatë trevjeçarit: reforma fiskale dhe reforma e administratës tatimore.

Deri më tani, gjendja e normave në të hyrat individuale, pra paga që e merr punëtori dhe e hyra e bizneseve që janë të regjistruara si biznese individuale, në Kosovë diku rreth 90% të bizneseve janë të regjistruara si biznese individuale dhe ato biznese afektohen nga ky ndryshim.

Ne kemi marrë vendim që të bëjmë zvogëlimin e të hyrave individuale të të hyrave individuale për 50%, përkatësisht nga 20 në 10% të çdo të hyre individuale që arrin mbi 450 euro.

Prej 250 deri në 450, do taksohen pra për diferencën, për 200 euro do të taksohen në vend të 10%, 8% dhe prej 250, po shkojmë poshtë, deri në 80, në vend të 5% do të taksohen 4%, ndërsa pjesa prej 0 deri në 80 prapë mbetet 0%. Me këtë qasje konsideroj se mundësohet që të gjitha shtresat të kenë një përfitim.

Ndryshimet në norma tatimore janë bërë në nenin 5, në nenin 18, në nenin 19, në nenin 20 të Rregullores 2004/52, të cilat besoj që me përkrahjen e juaj do të hyjnë në fuqi më 1 janar të vitit 2009.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Ryshaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Mufera Sinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Kosara Nikoliq, si dhe deputetët: Driton Tali, Vezira Emrush, Bahri Hyseni, Myrvete Pantina, Riza Smaka, Ramë Buja, Fatmir Rexhepi dhe Gani Buçinca, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i seancës e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër-----4,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tatimin në të ardhurat individuale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj nga fusha e përgjegjësisë të tyre dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Kosova, deri më tani në bazë të Rregullores ka aplikuar akcizë 17 euro për njësi konvencionale, përkatësisht 17 euro për kilogram të cigareve, që ka qenë niveli më i ulët në regjion.

Përmes kësaj norme, ne konsiderojmë se mbushim mungesën, përkatësisht humbjet eventuale buxhetore për shkak të ngritjes, përkatësisht uljes së taksave dhe prapë jemi në nivelin më të ulët në regjion. Nominalisht dhe realisht, do jemi prapë më të ulët në regjion.

Vendet e regjionit, siç është Shqipëria, e ka 19%, plus kanë doganën më të lartë në cigare. Maqedonia e ka më të lartë. Mali i Zi, Kroacia 35 euro.

Me këtë ngritje, ne ngrisim një akumulim përafërsisht 12 milionë euro më shumë në vit, e cila na mundëson që faktikisht t'i kompensojmë ato nevoja buxhetore të cilat na nevojiten për ngritjen e rrogave, ngritjen e pensioneve dhe nevojat tjera të zhvillimit të shtetit të Kosovës.

Ai kërkoi nga deputetët që ta mbështesin këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq, si dhe deputetët: Fatmir Rexhepi dhe Shkumbin Demaliaj, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i seancës e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër-----0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligji për normën e akcizës në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj nga fusha e përgjegjësisë të tyre dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen

Kryetari i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit përgjegjës raportues lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të deputetit Riza Smaka.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryetari hodhi në votim tekstin e ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për faljen.

9. Rishqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët

Kryetari i njoftoi deputetët me Vendimin e Kuvendit, të datës 30 korrik 2008, për procedimin me ligjet e pashpallura. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision përgjegjës raportues, në bazë të vendimit të Kuvendit ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët dhe Kuvendit i ka parashtruar Rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e komisionit funksional, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48,

Kundër----- 1,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

10. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit ka shqyrtuar Planin e veprimit të Kuvendit dhe të njëjtin ua ka dërguar grupeve parlamentare me kërkesë që ta shqyrtojnë dhe t'i paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre eventuale.

Në Planin e veprimit janë përfshirë edhe rekomandimet e Raportit të progresit të Komisionit Evropian që kanë të bëjnë me veprimet e Kuvendit dhe bashkëpunimin e tij me Qeverinë.

Në këtë plan janë përcaktuar objektivat themelore, si:

1. Të sigurohet organizimi dhe funksionimi sa më efikas i Kuvendit të Kosovës,
2. Të zhvillohet më tej një proces ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës,
3. Të fuqizohet roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj institucioneve që i zgjedh,
4. Të mbahen takime të rregullta të Kuvendit me zgjedhësit e tij,
5. Të zhvillohen kapacitetet adekuate të administratës së Kuvendit,
6. Të krijohen hapësira dhe kushte të nevojshme për punën e deputetëve dhe të organeve të Kuvendit,

Në plan janë përfshirë edhe objektiva të tjera specifike, si:

- Funksioni legjislativ,
- Funksioni mbikëqyrës,
- Mbikëqyrja e buxhetit dhe kontrolli i financave publike,
- Mbikëqyrja parlamentare e Agjencisë për Inteligjencë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- Bashkëpunimi me institucionet e tjera të pavarura,

- Funksioni përfaqësues,
- Kryetari dhe Kryesia,
- Grupet parlamentare,
- Komisionet parlamentare,
- Deputetët e Kuvendit,
- Administrata e Kuvendit.

Ai kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur më Planin e veprimit të Kuvendit.

Opinione dhe sugjerime lidhur me këtë plan dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sllobodan Petroviq, si dhe deputetët Edita Tahiri, Mahir Yagcilar, Riza Smaka, Njomza Emini dhe Sabri Hamiti, të cilat janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Planin e veprimit të Kuvendit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65

Kundër----- 2

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash u miratua Plan i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

11. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Rregulloren e Punës ka hartuar Projektregulloren e Punës së Kuvendit dhe e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit që ta arsyetojë Projektregulloren para deputetëve.

Zëvendëskryetari i Komisionit për Rregulloren e Punës, Kolë Berisha, prezantoi Projektregulloren e Punës së Kuvendit. Ai kërkoi, në emër të Komisionit për Rregulloren e Punës dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, nga deputetët që atë ta miratojnë.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur më Planin e veprimit të Kuvendit.

Opinione dhe sugjerime lidhur me këtë plan dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Mahir Yagcilar dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq, si dhe deputetët Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Haki Shatri, Nekibe Kelmendi, Riza Smaka, Fatmir Rexhepi, Hydajet Hyseni dhe Driton Tali, të cilat janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projekt-Rregulloren e Kuvendit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62

Kundër----- 0

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash miratohet, në parim, Projekt-Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Rregulloren e Punës, si komision përgjegjës dhe raportues, për të shqyrtuar Projektregulloren dhe Kuvendit t'ia paraqet raportin me rekomandime.

Komisionet e tjera të Kuvendit, grupet parlamentare dhe deputetët mund të shqyrtojnë Projektregulloren nga aspekti i fushëveprimit të tyre dhe amendamentet eventuale t'ia paraqesin Komisionit për Rregulloren e Punës.

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit që t'i paraqesë rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Kryetarja e Komisionit, Muzejene Selmani, prezantoi rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut. Ajo në emër të komisionit dhe të grupit Parlamentar të AKR-së i ftoi deputetët që t'i miratojnë këto rekomandime.

Kryetari hapi debatin për rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut.

Opinione dhe sugjerime lidhur me këtë plan dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Etem Çeku dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, si dhe deputetët Naim Rrustemi, Vezira Emrush, Emrush Xhemajli, Fatmir Rexhepi, Naser Rugova, Riza Smaka, Gani Geci, Myrvete Pantina, Hydajet Hyseni, Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Gani Buçinca, Ismet Beqiri, Synavere Rysha, Zef Morina, dhe ministri Ahmet Shala, të cilat janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, Kryetari hodhi në votim rekomandimet e Komisionit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 47

Kundër----- 10

Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi mbështetet, në parim, nismën e procesit të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut, duke përcaktuar prioritetet në kuadër të procesit të privatizimit, si vijon:

1. Së pari duhet të realizohet-përfundohet transformimi i plotë organizativ i korporatizimit të KEK-ut, duke i përcaktuar statusin formalo-juridik të secilës njësi në kuadër të Ndërmarrjes publike të KEK-ut.
2. Gjatë vitit 2009 të përcillen dhe të merren parasysh rezultatet e afarizmit ekonomik për secilën njësi veç e veç;
3. Të merret parasysh ndikimi i krizës globale në çmimin ofertues në procesin e privatizimit; dhe
4. Procedurat e privatizimit të fillojnë, varësisht nga rezultati i fizibilitetit (konkluzioneve analitike në aspektin e afarizmit ekonomik), me kusht që privatizimi i njësisë së caktuar të jetë prioritet dhe përparësi ekonomike për vendin.

Vazhdimi i seancës, më 15.12.2008, në orën 14:00

13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryetari informoi deputetët se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërimin e 2 anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ai hodhi në votim rekomandimin e Komisionit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61

Kundër----- 9

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë emërohen:

1. Përparim Kabashi, ing. i dip. i elektroteknikës, dhe
2. Blerim Koci, ing. i dip. i makinerisë.

II. Mandati i anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë zgjat pesë (5) vjet.

14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad Hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Mediave

Kryetari informoi deputetët se Komisioni Parlamentar Ad-Hoc ka shqyrtuar listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit Ad-Hoc raportin para deputetëve të Kuvendit e prezantoi deputeti Berat Luzha.

Kryetari hodhi në votim rekomandimin e Komisionit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 49,
Kundër----- 25,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit të Pavarur të Mediave emërohen:

1. Filloreta Bytyqi,
2. Sadija Nikshiq,
3. Agim Sopi, dhe
4. Ramë Bajraktari.

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Mediave zgjatë dy (2) vjet.

15. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad-Hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryetari informoi deputetët se Komisioni Parlamentar Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 2008/2 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil, ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit Ad-Hoc, raportin para deputetëve të Kuvendit e prezantoi deputeti **Hydajet Hyseni**.

Komisioni Parlamentar Ad-Hoc, në bazë të vlerësimit pas përfundimit të intervistës, Kuvendit të Republikës së Kosovës i paraqet këtë

R e k o m a n d i m

Për pozitën e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës propozohen këta kandidatë: Bajram Zogiani, Medi Geci, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, dhe Heset Mazrekaj, nga grupi i parë. Zgjidhen 3, nga 6 kandidatë sa janë.

Nga grupi i kandidatëve nga komuniteti minoritar joserbë, janë kandidatet Bisera Spahi dhe Resmije Mumxhi, zgjedhet njëra prej tyre.

Kryetari i njoftoi deputetët se votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është i fshehtë. Komisioni Ad-Hoc, në grupin e parë i ka propozuar 6 kandidatë, për 3 pozita dhe në grupin e dytë ka propozuar 2 kandidatë, për një pozitë.

Fletëvotimi është ndarë në dy grupe. Në grupin e parë, deputeti voton tre kandidatë dhe në grupin e dytë voton një kandidat të propozuar nga Komisioni Ad-Hoc.

Për zbatim të procedurës së votimit është krijuar Komisioni prej 3 zyrtarëve, ndërsa punën e tyre do ta monitorojë përfaqësuesi i secilit grup parlamentar.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që t'i caktojnë përfaqësuesit e tyre për të vëzhguar procesin e votimit.

Grupi Parlamentar i PDK-së propozoi deputetin Nait Hasani, Grupi Parlamentar i LDK-së propozoi deputetin Ismet Beqiri, Grupi Parlamentar i AKR-së propozoi deputeten Suzan Novobrdaliu, Grupi Parlamentar i AAK-së propozoi deputeten Donika Kadaj, Grupi Parlamentar i LDD-së propozoi deputetin Naser Rugova, Grupi Parlamentar "7+" propozoi deputeten Shpresa Murati dhe Grupi Parlamentar i SLS-së propozoi deputetin Mursel Halil,

Pastaj, kryetari vazhdoi t'i thërras deputetët, një nga një, për të votuar për kandidatët e propozuar.

Pas mbarimit të procesit të votimit, kryetari kumtoi rezultatet e votimit. Në bazë të rezultatit të votimit, Kuvendi mori këtë

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, emërohen:

1. Mehdi Geci,
2. Bajram Zogiani,
3. Bajram Ajeti, dhe
4. Bisera Spahi.
- 5.

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës zgjat pesë (5) vjet.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën, në orën 17:30.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**